

VENDIM
Nr. 51, datë 20.6.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.6.2024 mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 20 (L) 2023, që u përket:

KËRKUES: Lulzim Jajaga, përfaqësuar nga avokat Elton Gogo, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Qemal Brahja, Skënder Brahja, përfaqësuar nga avokat Ermal Fortuzi. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, përfaqësuar nga drejtor Çelsea Terziu.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1392, datë 4.6.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-3164, datë 26.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Lënia në fuqi e vendimit nr. 3817, datë 24.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sot Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 44, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 2, 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Lulzim Jajaga (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Qemal Brahjes, Skënder Brahjes dhe të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtorisë Vendore Tiranë Rurale 1 (*ASHK*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari është një nga trashëgimtarët e gjyshit të tij B.H.(J). Mbi kërkesën e trashëgimtarëve të këtij të fundit, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i Bashkisë së Tiranës (*KKKP-ja e Bashkisë së Tiranës*), me vendimin nr. 412, datë 7.11.2000 (*vendimi nr. 412/2000*), bazuar në ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, të ndryshuar (*ligji nr. 7698/1993*), ndër të tjera, ka vendosur njohjen pronarë dhe kthimin atyre të një trualli me sipërfaqe totale 11.181 m², të ndodhur në Sauk, Tiranë, me kufij të përcaktuar. Vendimi është

regjistruar në regjistrat e kohës të zyrës së hipotekës Tiranë dhe, në vijim, pasuria është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Në vitin 2006 një pjesë e pasurisë, trualli me sipërfaqe 3112 m² (identifikuar në regjistrat e pasurive të paluajtshme si pasuria nr. 78/15, zona kadastrale nr.3266), është regjistruar në bashkëpronësi të kërkuarit dhe nënës së tij Z.J., dhe pas vdekjes së kësaj të fundit, në pronësi vetëm të kërkuarit, i cili është pajisur në vitin 2012 me certifikatë pronësie.

2. Në datën 23.2.2011 kërkuari ka paraqitur në gjykatë një kërkesëpadi me të cilën ka paditur shtetasit Qemal dhe Skënder Brahja, duke kërkuar detyrimin e tyre për t'i liruuar dhe dorëzuar atij truallin me sipërfaqe 3112 m² (trualli objekt mosmarrëveshjeje), bazuar në nenin 296 të Kodit Civil (KC). Në gjykim është thirrur si person i tretë Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, e cila më pas, për shkak të ligjit, është zëvendësuar me ASHK-në, Drejtorinë Vendore Tiranë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3817, datë 24.3.2014, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar të paditurit Brahja t'i lironin dhe dorëzonin paditësit (kërkuarit) truallin objekt mosmarrëveshjeje, me arsyetimin se ky i fundit ishte pronar i ligjshëm i pasurisë dhe, për rrjedhojë, të paditurit Brahja ishin posedues të paligjshëm të saj. Kundër këtij vendimi të paditurit Brahja kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1392, datë 4.6.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkuarit, me arsyetimin se ai nuk duhej të ngrinte padinë e kërkuarit të sendit, por të kundërshtonte vendimet nr. 28, datë 11.3.1994 (*vendimi nr. 28/1994*) dhe nr. 446, datë 24.8.2000 (*vendimi nr. 446/2000*) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Këshillit të Rrethit Tiranë (KKKP-ja e Këshillit të Rrethit Tiranë), mbi bazën e të cilave të paditurit posedonin pronën në mënyrë të ligjshme. Sipas gjykatës së apelit, KKKP-ja Tiranë nuk mund t'i njihte dhe t'i kthente pronën paditësit (kërkuarit), për sa kohë ajo u ishte njohur dhe kthyer më parë trashëgimtarëve Brahja nga organi i ngarkuar nga ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuari.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, mbështetur në nenin 480, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Civile (KPC), me vendimin nr. 00-2023-3164, datë 26.7.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, sipas përmbajtjes së kësaj dispozite në kohën e paraqitjes së rekursit.

5. Në datën 16.11.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 1.12.2023. Kolegji i Gjykatës në datën 5.2.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, duke thirrur si subjekte të interesuara, në bazë të nenit 39 të ligjit nr. 8577/2000, palët ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, kundër të cilave është paraqitur kërkesa dhe që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen.

6. Prapësimet e parashtruara nga subjektet e interesuara, Qemal dhe Skënder Brahja u konstatua se janë nënshkruar edhe nga shtetasi Lulzim Brahja. Ky i fundit nuk ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe, për këtë arsye, nuk është thirrur si subjekt i interesuar në gjykimin kushtetues. Për sqarimin e faktit nëse ai po vepronte si përfaqësues i subjekteve të interesuara në fjalë, ndërsa ishte njoftuar se mund të ushtronte të drejta procedurale në emër të palëve në proces vetëm nëse ishte pajisur me tagra përfaqësimi sipas ligjit, atij i është kërkuar paraqitja e aktit të përfaqësimit/prokurës të lëshuar për të nga subjektet e interesuara. Shtetasi Lulzim Brahja nuk e ka paraqitur një akt të tillë përfaqësimi, për rrjedhojë nuk u legjitimua të merrte pjesë në gjykimin kushtetues, në kuptim të nenit 39, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000 dhe as të ushtronte të drejta procedurale të palëve në këtë gjykim.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë të paanshme dhe parimit të kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit edhe pse në prani të vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta me qëndrime të kundërta. Ajo gjykatë ka vendosur në mungesë të palëve dhe duke mos arsyetuar në bazë të provave, pa pasur asnjë arsyetim ligjor dhe logjik, si dhe duke mos e ushtruar rolin e saj si gjykatë ligji. Këto parime janë cenuar edhe nga gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar se vendimi i palës së paditur është një vendim më i hershëm se ai i kërkuesit, duke mos marrë parasysh se të paditurit nuk e kishin të regjistruar pronën sipas ligjit në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe se ata nuk kishin ndërmarrë ndonjë proces administrativ për kundërshtimin e regjistrimit të bërë në favor të kërkuesit dhe për regjistrimin e vendimeve të tyre, që pretendojnë se i kanë që nga viti 1994. Vendimi i gjykatës së apelit është i paarsyetuar dhe nuk mbështetet në asnjë normë juridike.

7.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën për të pasur një zgjidhje efektive*, sipas nenit 13 të KEDNJ-së, pasi gjykata e apelit nuk ka analizuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje padisë së kërkuesit në lidhje me të drejtën e pronësisë për sendin, por ka vendosur rrëzimin e saj, me arsyetimin se vendimi nr. 412/2000 i KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të tij është një akt administrativ i pavlefshëm, megjithëse nuk ka pasur në shqyrtim një padi (kundërpadi) të tillë dhe, për më tepër, kur të paditurit e kanë humbur të drejtën për kundërshtimin e këtij vendimi, pasi ka 22 vjet që ai ka prodhuar pasojat e tij juridike. Edhe Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, nuk ka arsyetuar në bazë të provave dhe ligjit. Vendimi i saj është alogjik, ndërsa është shprehur se gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, në një kohë kur ato kanë mbajtur qëndrime të ndryshme.

7.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi procesi gjyqësor ka filluar në vitin 2011 dhe ka përfunduar vetëm në vitin 2023.

7.2. *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi kërkuesi pronësinë e tokës e ka fituar me trashëgimi, konfirmuar me vendimin nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës, e cila është regjistruar sipas ligjit në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Edhe nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga ASHK-ja, për qëllime të gjykimit kushtetues, konfirmohet sërish se pasuria ka qenë dhe vijon të jetë e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të kërkuesit, me përjashtim të sipërfaqes 310 m², e cila padrejtësisht dhe në kundërshtim me ligjin është legalizuar në favor të subjektit të interesuar Qemal Brahja, ndërsa çështja ka qenë në proces gjyqësor në Gjykatën e Lartë. Pavarësisht se kërkuesi është pronar, subjektet e interesuara vijnë të posedojnë pasurinë e tij.

7.3. *Të drejtën për jetë private dhe familjare*, të garantuar nga nenet 2 dhe 8 të KEDNJ-së.

8. **Subjektet e interesuara, Qemal Brahja dhe Skënder Brahja**, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar se:

8.1. Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka paraqitur në mënyrë shteruese faktet, rrethanat dhe më pas ka vlerësuar dhe argumentuar vendimin e mospranimit të rekursit. Në këtë rast nuk kemi shkelje të gjykimit të drejtë, por mospranim të fakteve nga kërkuesi.

8.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës private është i pabazuar, pasi trashëgimtarët Brahja janë pronarë të pasurisë objekt konflikti. Ata kanë ndjekur procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe janë pajisur me vendimet nr. 28/1994 dhe nr. 466/2000 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, të cilat i kanë regjistruar në zyrën e hipotekës dhe e posedojnë pronën në mënyrë të ligjshme. Vendimi nr. 412/2000 i KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të kërkuesit është i pavlefshëm dhe trashëgimtarët Brahja kanë ngritur aktualisht padi për pavlefshmërinë e tij dhe rregullimin e pasojave përpara gjykatës së shkallës së parë. Mosmarrëveshja mes palëve duhet të zgjidhet me padinë e themelit dhe jo me padinë e rivendikimit, sikurse është shprehur edhe gjykata

e apelit. Është në vullnetin e kërkuessit të kërkojë dëmshpërblim për legalizimin e bërë nga Qemal Brahja ose të presë vendimin e gjykatës për pavlefshmërinë e vendimit nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës.

9. **Subjekti i interesuar, ASHK-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

9.1. Subjektet e interesuara e posedojnë pasurinë mbi një akt të ligjshëm dhe nuk rezulton që kërkuessit t'i jenë cenuar të drejta kushtetuese.

9.2. Për sa i përket gjendjes juridike aktuale të pronës objekt mosmarrëveshjeje, pasurisë nr. 78/15, zona kadastrale nr. 3266, truall, me sipërfaqe 3112 m², ajo është ndarë në dy pasuri: 1) pasuria nr. 78/19, me sipërfaqe 310 m², e regjistruar në emër të Qemal Brahjes dhe, më pas, në emër të A.B., në bazë të kontratës së dhurimit; 2) pasuria nr. 78/20, me sipërfaqe 2802 m², e regjistruar në emër të Lulzim Jagagës. Për sipërfaqen 310 m², përfituar nga Qemal Brahja me leje legalizimi, shtetasit Z.J. dhe Lulzim Jagaga janë shpronësuar me VKM-në nr. 543, datë 19.9.2021. Mbi pasurinë nr. 78/20, në pronësi të Lulzim Jagagës, pozicionohet pjesërisht pasuria nr. 78/11, ndërtesë me sipërfaqe 59,7 m², e cila figuron në emër të Qemal Brahjes, përfituar me leje legalizimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuessit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shkrimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkuessi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Në lidhje me kriterin e *shërimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shëruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata vëren se kërkuessi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi, sipas tij, procesi gjyqësor ka filluar në vitin 2011 dhe ka përfunduar vetëm në vitin 2023, pra pas më shumë se 12 vjetësh. Gjykata konstaton se në lidhje me këtë pretendim të ngritur në ankimin kushtetues individual kërkuessi nuk ka provuar që të ketë përdorur më parë mjetet juridike efektive që ofron legjislacioni në fuqi, në kuptim të parashikimeve të neneve 399/1 - 399/12 të KPC-së, që garantojnë për palët në gjykim të drejtën për të kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kjo vonesë. Si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Për

rrjedhojë, Gjykata vlerëson se për këtë pretendim kërkuksi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

14. Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata vëren se kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual, ndaj plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive.

15. Kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 26.7.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 16.11.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuksi ka parashtruar pretendime si në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në aspektet e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për një zgjidhje efektive, si dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, ashtu edhe në drejtim të së drejtës së pronës private dhe së drejtës për jetë private dhe familjare, të cilat janë me natyrë kushtetuese.

17. Gjykata vëren se për pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private dhe asaj familjare, të garantuara nga nenet 2 dhe 8 të KEDNJ-së, kërkuksi nuk ka parashtruar argumente konkrete për të mbështetur këtë pretendim dhe se në cilat aspekte janë cenuar këto të drejta gjatë procesit gjyqësor ose nga vendimmarrja e kundërshtuar e gjykatave të zakonshme. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

18. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuksit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për një zgjidhje efektive dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata vëren se ato, për nga natyra dhe përmbajtja e tyre, kanë të bëjnë, në thelb, me të drejtën e kërkuksit për të marrë përgjigje përfundimtare nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, ndaj, për rrjedhojë, ato do të vlerësohen në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të parashtruara nga kërkuksi, si edhe pozicionin e Gjykatës së Lartë dhe funksionin e saj si gjykatë ligji, në ushtrimin e të cilit ajo kontrollon jo vetëm mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, por edhe respektimin e standardeve kushtetuese për proces të rregullt, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim nëse ajo gjykatë ka garantuar të drejtën e kërkuksit për proces të rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës në aspektet e evidentuara më sipër.

19. Në lidhje me pretendimin e kërkuksit për cenimin e së drejtës së pronës private, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, çmon ta shqyrtojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

20. Kërkuksi ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka analizuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje padisë së kërkuksit në lidhje me të drejtën e pronësisë për sendin, por ka vendosur rrëzimin e saj me arsytimin se vendimi nr. 412/2000 i KKKP-së i Bashkisë së Tiranës në favor të tij është një akt administrativ i pavlefshëm, megjithëse nuk ka pasur në shqyrtim një padi (kundërpadi) të tillë dhe, për më tepër, kur të paditurit e kanë humbur të drejtën për kundërshtimin e këtij vendimi, pasi ka 22 vjet që ai ka prodhuar pasojat e tij juridike. Sipas kërkuksit, gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh se të paditurit nuk e kanë të regjistruar pronën sipas ligjit në regjistrat e pasurive të

paluajtshme dhe se ata nuk kanë ndërmarrë ndonjë proces administrativ për kundërshtimin e regjistrimit të bërë në favor të tij dhe për regjistrimin e vendimeve të tyre, të cilat pretendojnë se i kanë që nga viti 1994. Ai ka pretenduar se Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka arsyetuar në bazë të provave dhe ligjit, ndërsa vendimi i saj është alogjik, pasi është shprehur se gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, në një kohë kur ato kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Sipas kërkuessit, ai e ka fituar pronësinë për tokën me trashëgim, konfirmuar me vendimin nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës, i cili është regjistruar sipas ligjit në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe pavarësisht se është pronar, subjektet e interesuara vijnë të posedojnë pasurinë e tij.

21. Subjektet e interesuara, Qemal dhe Skënder Brahja, kanë prapësuar se Gjykata e Lartë ka paraqitur në mënyrë shteruese faktet, rrethanat dhe më pas ka vlerësuar e argumentuar vendimin e mospranimit të rekursit. Sipas tyre, trashëgimtarët Brahja janë pronarë të pasurisë objekt konflikti, ndërsa kanë ndjekur procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe janë pajisur me vendimet nr. 28/1994 dhe nr. 466/2000 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, të cilat i kanë regjistruar në zyrën e hipotekës, duke e poseduar pronën në mënyrë të ligjshme. Ata kanë prapësuar se mosmarrëveshja mes palëve duhet të zgjidhet me padi themeli dhe jo me padinë e rivendikimit, sikurse është shprehur edhe gjykata e apelit. Sipas tyre, regjistrimi i pronës dhe pajisja me certifikatë e kërkuessit nga ASHK-ja është e kundërligjshme, çka do të rregullohet në procesin që ata kanë vënë në lëvizje për pavlefshmërinë e vendimit nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të kërkuessit.

22. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, në parashtimet drejtuar Gjykatës ka paraqitur gjendjen juridike aktuale të pasurisë objekt mosmarrëveshjeje, duke u shprehur se subjektet e interesuara e posedojnë pasurinë mbi një akt të ligjshëm dhe nuk rezulton që kërkuessit t'i jenë cenuar të drejta kushtetuese.

23. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në jurisprudencën kushtetuese, nën dritën e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, është vlerësuar edhe çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta (*shih vendimet nr. 86, datë 26.12.2017; nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur gjykatat e faktit kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta, merr rëndësi përcaktuese natyra kushtetuese e pretendimeve që kërkuessi ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Lidhur me këtë, Gjykata ka theksuar se detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe

juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje nga kërkuesi përmes padisë për rivendikimin e sendit nga të paditurit Brahja. Ai ka pretenduar se është pronar i ligjshëm i truallit objekt mosmarrëveshjeje, fituar me trashëgimi, ndërsa gjyshi i tij e ka blerë atë në vitin 1933 dhe se pas marrjes pa të drejtë nga shteti pas vitit 1944, prona i është njohur dhe kthyer sipas ligjit me vendimin nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës, duke e regjistruar atë rregullisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Pavarësisht kësaj, sipas kërkuesit, pa vullnetin e tij, prona mbahej nga të paditurit Brahja, të cilët nuk pranonin t'ia dorëzonin. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka pranuar padinë e kërkuesit, duke detyruar të paditurit Brahja t'i lironin dhe dorëzonin atij truallin objekt mosmarrëveshjeje. Ajo gjykatë ka pranuar se kërkuesi është pronar i ligjshëm i pasurisë, njohur dhe kthyer me vendimin nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës dhe të regjistruar rregullisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pasuri e cila pa vullnetin e tij posedohej në mënyrë të paligjshme nga të paditurit. Nga ana tjetër, pa ndonjë arsyetim, gjykata nuk ka pranuar prapësimin e këtyre të fundit për posedimin e ligjshëm të truallit në bazë të vendimeve nr. 28/1994 dhe nr. 446/2000 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë dhe as atë për pavlefshmërinë e vendimit nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të kërkuesit.

28. Mbi ankimin e të paditurve Brahja, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuesit. Ky i fundit, sipas gjykatës së apelit, nuk duhej të ngrinte padinë e kërkimit të sendit, por të kundërshtonte vendimet nr. 28/1994 dhe nr. 446/2000 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, mbi bazën e të cilave të paditurit posedonin pronën në mënyrë të ligjshme. Ajo gjykatë ka gjetur të drejtë pretendimin në ankim të të paditurve, duke u shprehur se KKKP-ja nuk mund t'i njihte dhe t'i kthente pronën paditësit (kërkuesit), por duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës së tij, për sa kohë prona u ishte njohur dhe kthyer më parë trashëgimtarëve Brahja nga organi i ngarkuar nga ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës. Megjithatë, pavarësisht këtij përfundimi, në pjesën urdhëruese të vendimit nuk ka ndonjë disponim konkret në lidhje me vendimin e KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të kërkuesit. Nga ana tjetër, bazuar në këto përfundime, gjykata e apelit nuk ka vlerësuar të shqyrtojë më tej përkatësinë e së drejtës së pronësisë për truallin objekt mosmarrëveshjeje dhe as ka vënë në diskutim pretendimin e kërkuesit për mungesën e kompetencës tokësore të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë në marrjen e vendimeve në favor të trashëgimtarëve Brahja.

29. Kërkuesi ka paraqitur rekurs, duke ngritur pretendime për shkelje të ligjit material dhe atij procedural nga gjykata e apelit e cila, sipas tij, nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel në lidhje me të drejtën e pronësisë, ka dalë tej objektit të mosmarrëveshjes kur pa pasur padi (kundërpadi) ka shqyrtuar vlefshmërinë e vendimit të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës të dhënë në favor të tij, si dhe ka gabuar në çmuarjen e provave, pasi ka çmuar si të tilla akte shkresore të të paditurve që nuk janë marrë në formën e kërkuar nga ligji dhe nuk ka çmuar provat e tij për origjinën e pronës. Për

rekursin e kërkesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara në të nuk bënë pjesë në ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së dhe se nuk rezultonte që gjykatat më të ulëta të kishin lejuar shkelje procedurale që ta bënin të pavlefshëm procesin dhe të ndikonin në vendimarrjen e tyre, ndërkohë që ato kanë respektuar ligjin material duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, ndërsa vendimet e tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

30. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar me ankimin kushtetues individual është vënë në lëvizje nga kërkuesi nëpërmjet një padie rivendikimi, sipas nenit 296 të KC-së, si padia kryesore për mbrojtjen e pronësisë, me anë të së cilës pronari kërkon kthimin e sendit të vet nga personi që e mban atë pa shkak juridik. Gjykata e shkallës së parë, duke iu referuar natyrës dhe llojit të kësaj padie, e ka shqyrtuar dhe zgjidhur konfliktin mes palëve ndërgjyqëse si një mosmarrëveshje me natyrë civile, duke analizuar nëse në rastin konkret plotësoheshin kushtet e padisë së rivendikimit të sendit. Ndërkohë, ndryshe nga ajo, gjykata e apelit e ka shqyrtuar mosmarrëveshjen, në thelb, si të natyrës administrative. Sipas gjykatës së apelit, kërkuesi nuk duhet të ngrinte padinë e kërimit të sendit, por të kundërshtonte vendimet e KKKP-së (së Këshillit të Rrethit Tiranë) të dhëna në favor të paditurve, ndërsa në vijim, për pretendimin e ngritur në ankimin e të paditurve, është ndalur në analizën e vlefshmërisë së vendimit të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës të dhënë në favor të kërkesit, duke arritur në përfundimin se ky organ ka disponuar për një pronë për të cilën kishte disponuar më parë dhe, për këtë shkak, duhej të kishte rrëzuar kërkesën e kërkesit.

31. Për sa më lart, Gjykata rithekson se vendimet e organeve administrative që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave ndër vite nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit (*strictu sensu*), por akte *sui generis* të nxjerra nga një organ *sui generis*, një *quasi* gjykatë. Kur një person vinte në lëvizje KKKP-në, kërkesa ishte e barasvlershme si të ishte bërë përpara gjykatës dhe vendimi i KKKP-së ishte në gjendje të krijonte të njëjtën pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor, i cili i njeh individit pronësinë për një send (*shih vendimet nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 27, datë 26.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Po kështu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në vendimin unifikues nr. 24, datë 13.3.2002, është shprehur se ligji nr. 7698/1993 nuk është mënyrë e re fitimi pronësie, por korrigjim i padrejtësisë së bërë, duke u rinjohur ish-pronarëve të drejtën e pronësisë dhe kthyer atyre pronat e marra pa të drejtë dhe, në pamundësi, duke i kompensuar ata. Kurse në vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, Gjykata e Lartë është shprehur se vendimi i KKKP-së nuk trajtohet dhe nuk goditet në gjykatë si akt i mirëfilltë administrativ. Subjekti kërkuar në një gjykim të zakonshëm kundërshton vendimin e KKKP-së dhe kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të së drejtë të tij të pronësisë. Sipas Gjykatës së Lartë, në këto gjykime, gjykata zhvillon një gjykim themeli lidhur me titullin e pronësisë, duke ndryshuar ose shfuqizuar vendimin e KKKP-së, si dhe duke zgjidhur në themel këtë mosmarrëveshje që lidhet me të drejtën e pronësisë, pra ky gjykim është i natyrës civile.

33. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është ndodhur përpara dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në drejtim të mënyrës se si e kanë përcaktuar mosmarrëveshjen mes palëve. Gjykata thekson se edhe pse kjo nuk sjell *apriori* cenim të së drejtës për proces të rregullt, mënyra se si kanë vepruar gjykatat në rastin konkret ka sjellë edhe një mënyrë të ndryshme analize dhe vlerësimi ligjor të çështjes nga ana e tyre, çka impononte për Gjykatën e Lartë ushtrimin e rolit të saj si gjykatë ligji për të verifikuar mënyrën e zbatimit të ligjit dhe vendimeve të saj unifikuese nga gjykatat më të ulëta. Po kështu, ndonëse në rekursin e kërkesit janë ngritur pretendime për parregullsinë e procesit gjyqësor në disa aspekte të caktuara, sikundër edhe për të drejtën e pronës private, Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e tij, nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në të dhe në këtë mënyrë nuk ka ushtruar rolin e saj kushtetues. Ajo gjykatë ka disponuar

sipas nenit 480, shkronja “a”, të KPC-së, që përcakton se mospranimi i rekursit bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, por pa treguar se përse shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuarit nuk përfshihen në ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e depozitimit të rekursit apo se ato shkaqe nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, duke qenë kështu haptazi të pabazuara. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se edhe gjykatat më të ulëta nuk kanë lejuar shkelje procedurale që ta bënin të pavlefshëm procesin dhe të ndikonin në vendimmarrjen e tyre, si dhe kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, në një kohë kur gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për natyrën e mosmarrëveshjes dhe zbatimit të ligjit material.

34. Gjykata mban në konsideratë, në kuadër të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, se vetëm një vendim i arsyetuar i jep asaj mundësinë të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet kryesore të palëve dhe mënyrën se si i kanë trajtuar ato. Veçanërisht kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit zakonshëm gjyqësor, mungesa e arsytimit të Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi/pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar ato pretendime.

35. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se, referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në rekurs, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtëm të zbatimit të ligjit material, ashtu edhe në drejtëm të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit që kishin të bënin me aspekte kushtetuese të procesit gjyqësor. Në këto kushte, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, mospranimi i rekursit të kërkuarit nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsytimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit procedural nga ajo është haptazi i paarsyeshëm. Për pasojë, kemi cenim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

36. Për më tepër, Gjykata vlerëson të theksojë se, sikurse evidentohet edhe në prapësimet e subjekteve të interesuara, mosmarrëveshja e pronësisë mes palëve vijon ende për sa kohë ato (subjektet e interesuara) referojnë të kenë vënë në lëvizje një proces tjetër gjyqësor në të cilin kundërshtojnë pikërisht vendimin e KKKP-së së Bashkisë së Tiranës dhënë në favor të kërkuarit. Ndërkohë, ky i fundit, pavarësisht se është gjyqumbës në procesin gjyqësor objekt shqyrtimi, ka vijuar të trajtohet nga shteti si pronar, pasi jo vetëm është shpronësuar për një pjesë të truallit objekt mosmarrëveshjeje, por edhe figuron ende në regjistrat e pasurive të paluajtshme si pronar i pjesës më të madhe të pasurisë në konflikt. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se ishte detyrë e Gjykatës së Lartë që të verifikonte, po në ushtrim të funksionit të saj, edhe mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë trajtuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjen në gjykim, në raport me të drejtën e kërkuarit për të pasur një përgjigje përfundimtare për pretendimet në lidhje me të drejtën e pronës private.

37. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i bazuar, ndaj ky vendim duhet të shfuqizohet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuarit duhet të pranohet pjesërisht, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3164, datë 26.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.6.2024.

Shpallur më 19.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtar: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim